

Përmbytjet në Kosovë
po bëhen gjithnjë
e më të shpeshta



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RINUMËROHEN MBI 75 PËR QIND E VENDVOTIMEVE, PROCESI PRITET TË PËRFUNDOJË DERI NË FUND TË MUAJIT



Mbi 75 për qind e vendvotimeve janë rinumëruar në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve në Prishtinë, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve planifikon që i gjithë procesi të përmbyllet deri në fund të këtij muaji. Kështu ka bërë me dije zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ndërkaq, KQZ-ja po përballë me akuza për ndryshime të njëanshme në metodologjinë e rinumërimit të votave që, sipas ish-deputetit të PDK-së, Bekim Haxhiu, ka cenuar besimin e qytetarëve dhe kandidatëve në integritetin e procesit zgjedhor

**PËRFAQËSUESIT E
"LIRIA KA EMËR"
TAKOJNË KRYETARIN E
RAHOVECIT, SIGUROJNË
MBËSHTETJE PËR
MARSHIN "DREJTËSI,
JO POLITIKË"** F. 5



INTERVISTË E AMBASADORIT TË KOSOVËS NË JAPONI,
SABRI KIÇMARI
**MËSIMET E KOSOVËS
PËR RIMËKËMBJEN
NGA SHKATËRRIMI:
"NUK KA RRUGË
TJETËR PËRVEÇ
DEMOKRACISË
LIBERALE"** F. 4-5



**VAZHDON BLOKADA
E TRANSPORTUESVE RAJONALË
NË KUFIJTË ME BE-në** F. 8



**ADEMI DHE WESTERLUND
DISKUTOJNË PËR THELLIMIN E
BASHKËPUNIMIT KOSOVË - SUEDI
NË SFERËN E FUTBOLLIT** F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RINUMËROHEN MBI 75 PËR QIND E VENDVOTIMEVE, PROCESI PRITET TË PËRFUNDOJË DERI NË FUND TË MUAJIT

Mbi 75 për qind e vendvotimeve janë rinumëruar në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve në Prishtinë, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve planifikon që i gjithë procesi të përmbyllet deri në fund të këtij muaji. Kështu ka bërë me dije zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ndërkaq, KQZ-ja po përballet me akuza për ndryshime të njëanshme në metodologjinë e rinumërimit të votave që, sipas ish-deputetit të PDK-së, Bekim Haxhiu, ka cenuar besimin e qytetarëve dhe kandidatëve në integritetin e procesit zgjedhor.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 JANAR - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar numërimi i fletëvotimeve sipas listës së vendvotimeve për të cilat KQZ-ja ka marrë vendim që të rinumërohen. Nga fillimi i këtij procesi (e martë, 13 janar 2026, ora 18:00) dhe deri më tani (e martë, 27 janar 2026, ora 10:00) janë rinumëruar rreth 75 % apo 1 887 nga 2 557 vendvotime. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për “Ekonomia Online” se që nga 13 janari në QNR po zbatohen dy vendime të KQZ-së për rinumërimin e gjithsej 2 557 vendvotimeve, ku është zhvilluar procesi zgjedhor më 28 dhjetor. “Që nga data 13 janar dhe deri më sot, kur ka filluar dita e 15, në QNR është duke vazhduar zbatimi i dy vendimeve të

KQZ-së, për rinumërimin e 914 vendvotimeve dhe ai për rinumërimin edhe të 1 643 vendvotimeve, që në përgjithësi kemi të bëjmë me rinumërimin e të gjitha vendvotimeve, 2 557, në të cilat është zhvilluar procesi i rregullt zgjedhor më 28 dhjetor. Numri i vendvotimeve që janë rinumëruar, kur shënon pak pas mesditës, është më shumë se 75 për qind dhe sigurisht se këto të dhëna do të ndryshojnë deri në orën 16:00, kur do të përfundojë orari i punës për ndërrimin e parë”, ka thënë ai. Sipas Elezit, procesi po zhvillohet sipas planit të paraparë dhe në QNR janë të angazhuara 76 epike numërimi. “Fillimisht procesi i rinumërimit, i cili ka filluar më 13 janar, është duke vazhduar sipas planifikimeve të KQZ-së. Në përgjithësi në QNR janë 76 epike numërimi të cilat angazhohen gjatë gjithë ditës. Sipas



planifikimeve dhe dinamikës që është duke u zhvilluar këtu në QNR, KQZ planifikon që procesi i rinumërimit për vendvotimet e mbetura pritet të përmbyllet deri në fund të këtij muaji, që i bie ditë e shtunë”, ka thënë ai. Ai ka sqaruar se pas shpalljes së rezultatit përfundimtar në fillim të shkurtit, KQZ-ja do t'i presë afatet ligjore për ankesa para certifikimit të zgjedhjeve. “Fillimisht pas shpalljes së rezultatit përfundimtar në fillim të muajit shkurt, KQZ-ja planifikon ta shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme. Shpallja e rezultatit nuk nënkupton certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve, sepse sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme subjektet politike dhe kandidatët kanë të drejtë t'i paraqesin ankesat e tyre ndaj këtij rezultati fillimisht në PZAP, pastaj palët mund të ankohen edhe në Gjykatën Supreme nëse janë

të pakënaqura me vendimin e PZAP-së. Pra, KQZ duhet të presë të kalojnë këto afate kohore para se të bëjë procedime të tjera. Koha se sa duhet që KQZ ta certifikojë rezultatit përfundimtar pasi ta bëjë shpalljen e këtij rezultati varet krejtësisht nga ankesat të cilat mund të paraqiten ndaj rezultatit përfundimtar”, ka thënë Elezi.

Haxhiu akuzon KQZ-në për manipulime gjatë rinumërimit të votave, kërkon të hetohet edhe kreu i këtij institucioni

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) po përballet me akuza për ndryshime të njëanshme në metodologjinë e rinumërimit të votave që, sipas ish-deputetit të PDK-së, Bekim Haxhiu, ka cenuar besimin e qytetarëve dhe kandidatëve në integritetin e

procesit zgjedhor. Haxhiu ka reaguar ndaj vendimeve të KQZ-së, duke thënë se po shndërrohet në palë aktive në deformimin e procesit zgjedhor “KQZ, në vend se ta mbrojë integritetin e votës, po ndryshon rregullat gjatë rinumërimit, duke u shndërruar nga arbitër i paanshëm, në palë aktive në deformimin e procesit zgjedhor”, ka shkruar Haxhiu. Ai shton se ndryshimi i metodologjisë nga rendi sipas komunave dhe vendvotimeve në një proces të fragmentuar ka prodhuar një devijim të qartë të trendit të rezultateve. “Ky ndryshim arbitrar ka dëmtuar rëndë besimin e kandidatëve dhe qytetarëve. Kur rinumërimi ndërpritet pa kriter, vazhdohet me komuna të tjera dhe humbet gjurmueshmëria e vendvotimeve, procesi bëhet i pabesueshëm”, tha Haxhiu. Haxhiu kërkon rikthimin e menjëhershëm të rinumërimit sipas rendit të komunave dhe transparencë të plotë. “Çdo votë e cenuar është një goditje ndaj demokracisë. Prokuroria duhet t'i nisë menjëherë hetimet për të gjitha vendimet dhe veprimet që kanë cenuar integritetin e procesit zgjedhor, duke filluar nga kreu i KQZ-së e deri te çdo individ që ka pasur guximin ta shkelë ligjin, ta deformojë procesin zgjedhor dhe ta manipulojë vullnetin e qytetarëve”, ka shkruar Haxhiu.

RUTTE: NATO-ja PRET NGA BEOGRADI PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË PËR SULMIN NË BANJSKË

BRUKSEL, 27 JANAR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, përsëriti se aleanca pret përgjegjësi nga autoritetet në Beograd për ngjarjet në Kosovë, përfshirë sulmin në Banjskë dhe sulmet ndaj ushtarëve të KFOR-it gjatë tensioneve në pranverën e vitit 2023. “Kam një marrëdhënie personale me presidentin [e Serbisë] Aleksandar Vuçiq. Njohim njëri-tjetrin prej shumë vitesh. Por, natyrisht, presim nga ai që ta përcaktojë përgjegjësinë për atë që ndodhi disa vjet më parë, për dy çështje. Për të dyja ka premtuar përcaktimin e plotë të përgjegjësisë”, tha Rutte. Këto deklarata Rutte i bëri gjatë adresimit në Komitetin për Punë të Jashtme të



Parlamentit Evropian (AFET), ku konfirmoi mbështetjen për dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Rutte, po ashtu, theksoi se NATO-ja është e përkushtuar

ndaj situatës së sigurisë në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar se aleanca ushtarake perëndimore nuk do të lejojë krijimin e një vakuumi të sigurisë në Bosnjë-Hercegovinë. Tensionet në mes të Kosovës

dhe Serbisë kanë qenë të rritura vitet e fundit dhe incidenti më i rëndë u regjistrua shtatorin e vitit 2023 në Banjskë të Zveçanit, kur një grup serbësh të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë një rreshter. Në këmbimet e zjarrit që pasuan u vranë tre sulmues serbë. Politikani nga Kosova dhe biznesmeni Millan Radoiqiq e mori përgjegjësinë për sulmin, dhe prej atëherë ai ndodhet në Serbi, ku nuk është ndjekur penalisht deri më sot. Këtij incidenti të armatosur i paraprijnë protestat në veri të Kosovës të mbajtura në maj të po atij viti. Më shumë se 90 pjesëtarë të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, kishin pësuar

lëndime - disa prej tyre lëndime të rënda - pas përleshjes me protestuesit serbë në Zveçan. Dhuna në Zveçan shpërtheu pasi serbët lokalë kundërshtuan hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe - pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më herët po atë vit, që u bojkotuan nga serbët lokalë. Për ngjarjet në Zveçan janë arrestuar dhe akuzuar dhjetëra persona, dhe disa janë dënauar me burgim pas marrëveshjeve me prokurorinë për pranimin e fajësisë. NATO-ja ka kërkuar që përgjegjësit për të dyja rastet të përballen me drejtësinë.

PËRMBYTJET NË KOSOVË PO BËHEN GJITHNJË E MË TË SHPESHTA

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 JANAR - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka bërë me dije se në vend vërshimet/përmbytjet po bëhen gjithnjë e më të shpeshta si pasojë e kushteve meteorologjike (intensitet i lartë i reshjeve për periudhë të shkurtë kohore, shkrija e shpejtë e borës), pastaj faktorët gjeomorfologjikë - relievi, pjesa më e madhe e ujërrjedhave, burimin e tyre ose formohen në viset më të larta të cilat rrjedhin rrëmbyeshëm në formë të rrëqeve.

Sipas një raporti të IHMK-së thuhet se vetëm disa lumenj, ose pjesë të tyre si p.sh lumi Sitnica, Ibri, rrjedha e mesme dhe e poshtme e Drinit të Bardhë, për shkak të karakterit fushorë, përmbysin më ngadalë, shkaku i sipërfaqes, pozitës, konfiguracionit të terrenit. “Në Kosovë brenda një periudhe pesëvjeçare kemi pasur paraqitje të përmbytjeve me shkallë më të lartë gjatë vitit 2021, 2023 dhe tani nga 5 - 8 janar 2026. Këto të fundit, ishin në përmasa me një periudhë kthyes hidrolgjike prej 50 viteve (sidomos pjesa perëndimore apo pellgu i Drinit të Bardhë). Si pasojë e reshjeve të shumta të shiut e pastaj edhe të shkrires së borës (sidomos në zonat më të lara malore), fillimisht në pjesën



perëndimore (Rrafshi i Dukagjinit), qendrore (disa pjesë të Rrafshit të Kosovës dhe Drenicës), e më pas edhe në pjesën më të madhe të vendit, lumenjtë kryesorë të Kosovës, si Drini i Bardhë (kryesisht rrjedha e mesme dhe e poshtme), pastaj, Ereniku, Mirusha, Toplluha, Bistrica e Deçanit, Lumi Klina, Sitnica, Drenica, Ibri etj. me degët e tyre, duke filluar nga datë 05-08/01/2026,

kanë pasur ngritje të shpejta dhe të larta të niveleve dhe prurjeve të ujit”.

IHMK-ja bën me dije se nga 08/01/2026 e deri më datë 10/01/2026, mesatarisht në territorin e së Kosovës kanë rënë 41.3 mm (l/m2) reshje, ndërsa nga data 01-10/01/2026, mesatarisht në Kosovë kanë rënë 124.1 mm, apo 64.9 mm ose 50.6 % më shumë se sasia mesatare e janarit 1961-2024.

Po ashtu, në njoftim thuhet se sasia më e lartë e reshjeve prej 400.4 mm (l/m2), gjatë kësaj periudha është regjistruar në Junik, pastaj në Glogjan 331.2 mm, Radoniq 280.8 mm, Kuqishtë 256.8 mm, Kramovik 245.5 mm, Gjakovë 217.3 mm, Restelicë 201.8 mm, Klinë 199 mm etj.

Siç vërehet nga të dhënat, sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar në pjesën perëndimore të Kosovës në Pellgu i Drinit të Bardhë 192.8 mm, ku si pasojë janë shkaktuar edhe vërshimet/përmbytjet më të mëdha.

Pastaj, ato kanë qenë më të theksuara në pellgun e Lepencit me mesatare 104.3 mm, me maksimumin e tyre prej 116.6 mm në Ferizaj.

Ndërsa në pellgun e Ibrit mesatarisht kanë rënë 89 mm, me maksimumin e tyre prej 164.8 në Komoran, pastaj në Drenas 154.2 etj. (Siç vërehet nga të dhënat sidomos të nën pellgut të Drenicës, janë regjistruar sasi më të larta të reshjeve, prandaj janë shkaktuar përmbytje, kryesisht në rrjedhën e tij të mesme dhe të poshtme).

Në pellgun e Moravës së Binçës mesatarisht kanë rënë 68.7mm, me maksimum në Vërbicë të Zhegocit ku janë regjistruar 89.9 mm.

Më tutje në njoftim thuhet se Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (sektori i hidrologjisë),

deri para situatës me përmbytje, ka operuar me një numër prej 34 stacionesh automatike Hidrometrike (GPRS), të cilat janë të vendosura në të gjitha pellgjet, duke përfshirë lumenjtë kryesorë si p.sh: Në pellgun e Drinit të Bardhë 12 stacione, Ibri 11, Morava e Binçës me 6, Lepenci 3 dhe lumi Plavës me 2 stacione hidrometrike. “Në 7 profile hidrometrike janë të instaluar sisteme të kamerave për fotogrametri, të cilat i regjistrojnë këta parametra: nivelin e ujit (h), shpejtësinë e rrjedhës (v) dhe prurjen (q). Në profilet tjera, janë të vendosur/instaluar censorët, të cilët e bëjnë regjistrimin e nivelit të ujit në intervale çdo 15, 30 dhe 1h. Të dhënat rruhen në data Logerin e tyre të cilat përmes sistemit GPRS, transferohen në serverin qendrorë të IHMK-s në Prishtinë. Aty bëhet, ruajtja, përpunimi, analizimi dhe pastaj publikimi i të dhënave pas një analize dhe kontrolli. Gjatë periudhës 5 -10 janar 2026, Republika e Kosovës ka përjetuar reshje intensive të shiut dhe shkrije të borës, çka ka ndikuar ndjeshëm në gjendjen dhe sjelljen e lumenjve kryesorë dhe ka shkaktuar përmbytje në shumë zona. Situata hidrologjike për këtë periudhë u monitorua Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK)”, theksohet në këtë raport.

PËRFAQËSUESIT E ‘LIRIA KA EMËR’ TAKOJNË KRYETARIN E RAHOVECIT, SIGUROJNË MBËSHTETJE PËR MARSHIN ‘DREJTËSI, JO POLITIKË’

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 JANAR - Platforma “Liria ka Emër” ka vazhduar të martën fushatën e takimeve nëpër Kosovë me një vizitë zyrtare në komunën e Rahovecit. Dy themeluesit e platformës, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, u pritën në takim nga kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.

Gjatë takimit përfaqësuesit e platformës paraqitën misionin dhe aktivitetet e “Liria ka Emër”, me theks të veçantë në fushatën e mobilizimit qytetar për Marshin “Drejtësi, jo politikë”, i cili do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të ish-krerëve të UÇK-së që po mbahen në Hagë.

Eliza Hoxha, bashkëthemeluese e platformës, theksoi se ky marsh është një thirrje qytetare për drejtësi të paanshme. “Kërkojmë mbështetje që zëri i qytetarëve të Kosovës të dëgjohet fuqishëm

më 17 shkurt”, shtoi ajo.

Ndërsa Ismail Tasholli, ndër të tjera, tha se mobilizimi në çdo komunë të Kosovës është thelbësor për përcimin e mesazhit të Marshit. “Marshi ‘Drejtësi, jo politikë’ është reagim i domosdoshëm kundër shndërrimit të drejtësisë në instrument politik”, shtoi Tasholli.

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, shprehu mbështetjen e tij për këtë nismë qytetare, duke vlerësuar rëndësinë e ruajtjes së dinjitetit të luftës çlirimtare dhe të parimeve të drejtësisë. “Drejtësia duhet të jetë e drejtë dhe e barabartë për të gjithë. Kjo është një kauzë që meriton mbështetje”, tha Latifi.

Platforma “Liria ka Emër” do të vazhdojë takimet dhe aktivitetet në të gjithë Kosovën, me qëllim mobilizimin sa më të gjerë qytetar për pjesëmarrje masive në Marshin e 17 shkurtit, nën moton “Drejtësi, jo politikë”.





INTERVISTË E AMBASADORIT TË KOSOVËS NË JAPONI, SABRI KIÇMARI, DHËNË REVISTËS SË SHOQATËS PËR POLITIKË TË JASHTME KASUMIGASEKI (KAFA)

MËSIMET E KOSOVËS PËR RIMËKËMBJEN NGA SHKATËRRIMI: 'NUK KA RRUGË TJETËR PËRVEÇ DEMOKRACISË LIBERALE'

TOKIO, 27 JANAR -

Me rastin e 15-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Japonisë dhe Kosovës, u tha se Nisma për Bashkëpunim me Ballkanin Perëndimor, e shpallur nga kryeministri Abe në vitin 2018, synon të kontribuojë në paqe dhe stabilitet në Kosovë dhe në rajon, duke mbështetur pajtimin rajonal dhe reformat socio-ekonomike. Si e vlerësoni gjendjen aktuale të marrëdhënieve ndërmjet Japonisë dhe Kosovës, përfshirë zbatimin e kësaj nisme? Në cilat fusha duhet të bashkëpunojnë më tej dy vendet tona përballë pasigurive globale?

Ambasadori Kiçmari: Iniciativa e ish-kryeministrit

Shinzo Abe, Nisma për Bashkëpunim me Ballkanin Perëndimor, ka rezultuar në veprime konkrete që kanë pasur ndikim pozitiv në paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe në rajon. Si rezultat i kësaj nisme, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Japonisë është emëruar ambasadori përgjegjës për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2020 Japonia hapi Ambasadën e saj në Kosovë, ndërsa vitin e kaluar u nënshkrua një marrëveshje bilaterale për heqjen e vizave për pasaporta diplomatike dhe zyrtare. Në nivel politik, bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve është intensiv dhe substancial. Kështu, në shtator 2022, kryeministri Kurti vizitoi

Japoninë për të marrë pjesë në ceremoninë shtetërore të varrimit të ish-Kryeministrit Shinzo Abe; në vitin 2023 u mbajtën konsultime politike ndërmjet dy ministrive; ndërsa në vitin 2024, në kuadër të shënimit të 15-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, u realizuan vizita të ndërsjella në nivel ministrash të jashtëm: Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme Donika Gërvalla Schwarz vizitoi Japoninë në maj 2024, ndërsa ministrja e Jashtme e Japonisë, Yoko Kamikawa, vizitoi Kosovën në korrik 2024, që ishte vizita e parë e një ministri të jashtëm japonez në Kosovën e pavarur. Dy vendet tona kanë qëndrime identike

për një sërë çështjesh ndërkombëtare dhe përfaqësojnë vlera politike të njëjta. Kosova e konsideron Japoninë një nga miqtë e saj më të afërt në Azi. Kosova është krenare që mbështet vizionin e Japonisë për një Indo-Paqësor të lirë dhe të hapur dhe synon të jetë partneri më i besueshëm i Japonisë në Evropën Juglindore.

Ekspozita Osaka - Kansai 2025 në Japoni mund të jetë një mundësi e shkëlqyer për të lidhur ekonominë japoneze me Kosovën. Çfarë mund t'u ofrojë Kosova industrive japoneze dhe konsumatorëve japonezë?
Ambasadori Kiçmari: Kosova paraqet një mjedis premtues

për investorët dhe sipërmarrësit japonezë të interesuar për të investuar në rajonin me zhvillim të shpejtë të Evropës Juglindore. Pozita e saj gjeografike, klima e favorshme e biznesit dhe fuqia punëtore e re dhe e arsimuar e bëjnë Kosovën një destinacion tërheqës për kompanitë japoneze. Sektori i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe progresi ekonomik i Kosovës ofrojnë mundësi premtuese bashkëpunimi. Nga projektet infrastrukturore, si autostrada Prishtinë - Durrës, deri te sipërmarrjet teknologjike, ekziston një potencial i madh. Ja një shembull konkret suksesi: Kosova sot është shtëpia e fabrikës më të

madhe të kërpuhave shiitake në Evropë, e themeluar nga një kompani japoneze. Shpresojmë që ky të jetë vetëm një nga shumë shembuj të investimeve të suksesshme.

Çfarë roli luan xhudoja në shkëmbimet kulturore ndërmjet Japonisë dhe Kosovës?

Ambasadori Kiçmari: Xhudoja nuk ka qenë një sport i popullarizuar në të kaluarën. Megjithatë, në 20 vitet e fundit ajo është shndërruar në një nga sportet më të njohura në Kosovë. Kjo është rezultat i sukseseve të ekipit kombëtar të xhudos, i cili ka fituar pesë medalje në tri Lojërat e fundit Olimpike, përfshirë dy medalje të arta në Lojërat Olimpike të Tokios në vitin 2021. Ekipi ynë i xhudos viziton shpesh Japoninë dhe zhvillon stërvitje këtu. Ministria e Punëve të Jashtme e Japonisë e ka njohur ekipin kombëtar të Kosovës si një ekip që ka ndikuar në promovimin e njërës prej sporteve tradicionale japoneze.

Një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u nënshkrua nën ndërmjetësimin e presidentit Donald Trump në vitin 2020. Cila është situata aktuale?

Ambasadori Kiçmari: Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2020 kishte kryesisht karakter ekonomik, për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo u pasua nga një tjetër marrëveshje më 27 shkurt 2023, e ndërmjetësuar nga BE-ja, për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, bazuar në parimin e njohjes reciproke të dokumenteve dhe simboleve kombëtare, përfshirë pasaportat, diplomat, targat e automjeteve dhe vulat doganore. Gjithashtu u dakordua që Serbia të mos e kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare. Më 18 mars 2023, kryeministri Kurti dhe presidenti serb Vuçiq u takuan në Ohër, Maqedonia e Veriut, dhe u pajtuan verbalisht për zbatimin e marrëveshjes. Megjithatë, zbatimi i saj ka qenë shumë i ngadalshëm.

A ka pasur ndonjë ndryshim në angazhimin e ShBA-së në këtë çështje nën administratën e dytë Trump?

Ambasadori Kiçmari: Disa javë pas marrjes së detyrës, presidenti Trump i dërgoi një letër urimi presidentes

Osmani me rastin e 17-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ai theksoi mbështetjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara për Kosovën dhe shprehu pritjen për zgjerimin e mëtejshëm të saj, veçanërisht përmes rritjes së mundësive të investimeve, për të sjellë prosperitet më të madh për të dy shtetet tona. Presidenti Trump gjithashtu nënvizoi rëndësinë e integritetit të mëtejshëm të Kosovës në komunitetin euroatlantik dhe vlerësoi mbështetjen e palëkundur të Kosovës për Ukrainën përballë agresionit rus.

Kam dëgjuar se Kosova është rimëkëmbur nga shkatërrimet e konfliktit të Kosovës dhe tani eksporton edhe verë. A mendoni se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i vendit ndihmon gjithashtu në avancimin e paqes dhe pajtimit në rajon? A janë ndikuar eksportet e Kosovës nga tarifat e Presidentit Trump?

Ambasadori Kiçmari: Shkatërrimet në Kosovë gjatë luftës së viteve 1998-1999 ishin të mëdha. Rreth 50 % e shtëpive, ndërsa në disa zona si Drenica, Rahoveci dhe Malisheva deri në 90 %, u shkatërruan nga bombardimet. U shkatërruan gjithashtu 70 % e urave dhe 60 % e shkollave. Rreth 900 000 refugjatë u zhvendosën në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi, si dhe në shumë vende evropiane. Pothuajse të gjithë refugjatët u kthyen brenda dy javësh në qershor 1999. Zonja Sadako Ogata, Komisionere e Lartë për Refugjatët, luajti një rol udhëheqës në kthimin e shpejtë të refugjatëve dhe në mbështetjen humanitare të tyre. Deri në vitin 2004 procesi i rindërtimit të vendit u përfundua: shtëpitë, shkollat dhe urat u rindërtuan. Shumë vende kontribuan në procesin e rindërtimit, përfshirë Japoninë me një sërë projektesh të JICA-s, si mbështetja për Radio Televizionin e Kosovës, iniciativa për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ruajtjen e mjedisit, kontrollin e ndotjes së ajrit, si dhe mbështetje për spitalet dhe shkollat e Kosovës. Administrata Trump ka vendosur një tarifë prej 10 % për eksportet nga Kosova drejt Shteteve të Bashkuara.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Guterres, ka deklaruar se Këshilli i Sigurimit i OKB-së është jofunksional. Sa e rëndësishme është për rajonin

që ShBA-ja të mbetet e përkushtuar ndaj OKB-së? Dhe çfarë mendoni se duhet të bëjnë shtetet anëtare të OKB-së për ta arritur këtë?

Ambasadori Kiçmari: Pushtimi rus i Ukrainës dëshmon se paqja e përhershme sipas modelit kantian pengohet nga e drejta e vetos. Këshilli i Sigurimit i OKB-së është penguar të ndërmarrë çfarëdo hapi, për shkak se Rusia përdor të drejtën e vetos kundër çdo iniciative. Kështu, shkelja brutale e Kartës së OKB-së nuk mund të ndëshkohet për shkak të kësaj të drejte vetoje. Kjo e bën të domosdoshëm rishikimin dhe reformimin e OKB-së, në drejtim të demokratizimit të proceseve vendimmarrëse dhe respektimit të fazës së re të m a r r ë d h ë n i e v e ndërkombëtare të krijuar pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Duhet të ketë përfaqësim më demokratik të shteteve me status të përhershëm (të paktën një shtet nga Afrika dhe një nga Australia). Japonia dhe Gjermania, si dy nga katër shtetet më të fuqishme ekonomike në botë dhe mbështetëse të vazhdueshme të programeve të OKB-së, duhet të fitojnë anëtarësim të përhershëm. Gjithashtu, India, me popullsinë më të madhe në botë, e meriton statusin e përhershëm në Këshillin e Sigurimit.

Nga sa kuptoj, jeta juaj ka pasur një rrugëtim sfidues që në vitet e adoleshencës, duke shkruar në Gjermani për studime në kushte konfliktesh dhe shtypjeje në vend. Cilat janë pikëpamjet tuaja për drejtimin e ardhshëm të politikës evropiane për migracionin dhe refugjatët?

Ambasadori Kiçmari: Jeta ime është e ngjashme me atë të shumicës së bashkëmoshatarëve të mi. Për shkak të zhvillimeve politike gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, shumë prej nesh u detyruam të largoheshim nga vendi si refugjatë. Pas shpërnguljes në Gjermani në vitin 1989, vendosa të studioj filozofi, shkencë politike dhe sociologji. Në të njëjtën kohë, isha i përkushtuar për të ndihmuar vendin tim, i cili ndodhej në prag të luftës. Pas përfundimit të luftës, u ktheva në Kosovë si profesor në Universitetin e Prishtinës. Por, gjashtë muaj pas Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, pata nderin të emërohesha si ambasadori i parë i Republikës së Kosovës në Austri. Kështu, rrugëtimi

im profesional u lidh me profesionin e diplomatit: si ambasadori i parë i Kosovës në Austri (2008-2013), në Australi (2013-2018) dhe, që nga janari 2022, si ambasador i Republikës së Kosovës në Japoni.

Evropa duhet ta trajtojë çështjen e refugjatëve në kontekstin e interesave të saj, duke respektuar të drejtën ndërkombëtare. Refugjatët nuk janë vetëm barrë; ata shpesh sjellin edhe vlera me vete. Ata ndikojnë në diversitetin shoqëror dhe kulturor. Evropa duhet të jetë e përgatitur për bashkëjetesë dhe të pranojë faktin se, në epokën e globalizimit, lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin dhe nga një rajon në tjetrin është e pamundur të parandalohet. Nga kjo lëvizje duhet të krijohen mundësi dhe ajo nuk duhet parë vetëm si pengesë.

Ju keni shkruar një libër me titull “Historia vazhdon: Tri modele të vazhdimit të historisë”. Ju lutem, na shpjegoni përmbajtjen e tij.

Ambasadori Kiçmari: Libri im trajton idenë e Francis Fukuyama-s për “Fundin e historisë”. Fukuyama shpalli fitoren ideologjike të demokracisë liberale dhe sistemit të tregut të lirë ndaj monarkisë, fashizmit dhe komunizmit. Teza e Fukuyama-s për “fundin e historisë” është kundërthënëse. Shprehja që ai ka zgjedhur për librin e tij nuk është e përshtatshme. Historia nuk është ideologji. Historia nuk mund të përfundojë, nëse me histori nënkuptojmë të kaluarën, të cilën e kujtojmë dhe e interpretojmë për t’u orientuar në të tashmen dhe të ardhmen. Fukuyama ka të drejtë të shpallë fitoren e demokracisë liberale, por variacionet e tjera ideologjike nuk janë zhdukur. Në Republikën Popullore të Kinës është përqaftuar ekonomia e tregut, por jo demokracia liberale. Në Rusi, autoritarizmi është rikthyer në versionin e tij hegjonik nacionalist, i cili përpiqet të sfidojë vlerat e demokracisë liberale. Ndryshimet demokratike që nisën në fillim të këtij shekulli në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme kanë rrëshqitur drejt rritjes së fundamentalizmit islamik sipas modelit iranian, në variantin e tij më ekstrem.

Nëse e shohim tezën e “fundit të historisë” nga këndvështrimi shkencor, atëherë mund të përfundojmë se një gjë e tillë është e pamundur. Pas “fundit të

historisë”, historia vazhdon. Prandaj, nuk ka fund të vërtetë të historisë. Historia nuk ka përfunduar: ajo po vazhdon tridhjetë vjet pas publikimit të tezës së Fukuyama-s.

Pra, ju argumentoni se historia e luftës ideologjike vazhdon edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Sot njerëzit janë seriozisht të shqetësuar për të ardhmen e demokracisë liberale. Duke u bazuar në përvojat e Kosovës gjatë 30 viteve të fundit, çfarë nevojitet për ruajtjen dhe madje përparimin e demokracisë liberale?

Ambasadori Kiçmari: Pas luftës në vitin 1999, Kosova ndërmori dy transformime radikale: ndryshimin e sistemit shtetëror nga ai i një vendi të pushtuar në një shtet të lirë dhe demokratik, si dhe transformimin e sistemit ekonomik nga ekonomia socialiste e trashëguar nga koha e Jugosllavisë në një ekonomi tregu. Në këtë kontekst, Kosova ka qenë me fat: ka përfituar shumë nga prania e OKB-së, NATO-s dhe BE-së, por edhe nga investimet e vendeve të veçanta si Japonia, Zvicra, Kanadaja dhe Australia, për përfundimin me sukses të rindërtimit të vendit, vendosjen e një sistemi liberal-demokratik dhe të një ekonomie të tregut të lirë. Në disa vende sot ka manifestime të hapura të ultranacionalizmit, fundamentalizmit fetar dhe militarizmit agresiv ndaj vendeve fqinje. Këto dukuri duhet të kundërshtohen duke përsheptuar procesin e integritetit në komunitete shumë-shtetërore liberal-demokratike si BE-ja dhe NATO-ja. Roli vendimmarrës i G7 duhet të rritet. Edhe vende jo-evropiane si Japonia, Australia dhe Kanadaja duhet të gjejnë forma integruese të bashkëpunimit me vendet që përfaqësojnë të njëjtin sistem vlerash. Vlerat politike të sistemit liberal-demokratik duhet të përhapen më këmbëngulësisht brenda shoqërive përmes sistemit arsimor dhe mediave. Pavarësia e sistemit gjyqësor është një vlerë e patjetërsueshme, ndërsa shmangia e dominimit të pakicës autoritare mbi shumicën demokratike kërkon qasje kreative dhe aktivizëm të vendosur.

(Intervistë e realizuar nga kryeredaktori i KaFSA-së, Kawamura Yasuhisa, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Japoni, më 2 maj 2025)

Komuna e Prishtinës nderon nxënësit fitues të Olimpiadës Komunale të Matematikës dhe Garave të Fizikës

PRISHTINË, 27 JANAR - Nxënësit e kryeqytetit po dëshmojnë çdo ditë se Prishtina ka një të ardhme të ndritur. Të martën komuna e Prishtinës ka nderuar nxënësit që u dalluan me rezultate të larta në Olimpiadën Komunale të Matematikës dhe në Garat Komunale të Fizikës. Me këtë rast u theksua rëndësia e dijes, përkushtimit dhe talentit të të rinjve, duke e vlerësuar matematikën dhe fizikën si bazë të zhvillimit të një qyteti modern, inovacionit, teknologjisë dhe ideve që e çojnë përpara kryeqytetin. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, shprehu mirënjohje për mësimdhënësit dhe prindërit për mbështetjen e vazhdueshme ndaj nxënësve, duke theksuar se suksesi i tyre është rezultat i një pune të përbashkët. “Sot nderuam dijen, përkushtimin dhe talentin e atyre që u dalluan në Olimpiadën Komunale të Matematikës dhe Garat Komunale të Fizikës. Matematika dhe fizika janë themeli i qytetit modern, i inovacionit, teknologjisë dhe ideve që e çojnë Prishtinën përpara. Faleminderit mësimdhënësve dhe prindërve për mbështetjen e vazhdueshme! Dija, përkushtimi dhe puna e këtyre nxënësve janë vlerat mbi të cilat ndërtohet Prishtina”, ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



VELIU KËRKON REFORMIM TË DEGËS SË LDK-së NË PODUJEVË: HUMBJET E NJËPASNJËSHME TREGOJNË KRIZËN

PODUJEVË, 27 JANAR - Agim Veliu përmes një postimi në “Facebook” ka bërë thirrje për reformim të menjëhershëm të degës së LDK-së në Podujevë. Ai ka thënë se dega e LDK-së në Podujevë ndodhet në krizë të thellë politike dhe organizative. “Pesë humbje rresht janë pasojë direkte e një kryetari të komanduar që ka humbur besimin e anëtarësisë, pa marrë asnjëherë përgjegjësi. Për më shumë se 30 vjet dega jonë ka qenë shembull i organizimit dhe fitoreve, ndërsa për mbi 20 vjet qytetarët ma kanë besuar pesë herë drejtimin e komunës. Kjo tregon se partia di të fitojë kur respektohen parimet,

demokracia e brendshme dhe baza e saj. Pas largimit tim dhe marrjes së kompetencave të kryesisë, me një vendim kundërstator dhe të padrejtë, Degës i janë imponuar vendime të mbyllura, përgjashtuese dhe pa legjitimitet”, ka shkruar Veliu. Ai ka theksuar se rezultati është i qartë: humbje, demotivim dhe largim i anëtarësisë. Veliu ka thënë se për herë të parë në historinë e zgjedhjeve parlamentare, dega e LDK-së në Podujevë nuk është e përfaqësuar me deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. “Prandaj, sot bëj thirrje të hapur dhe publike për ndryshime të menjëhershme në Degën e LDK-së në Podujevë. Në këtë situatë është e domosdoshme: Marrje përgjegjësie politike për dështimet e njëpasnjëshme. Hapje e Degës ndaj anëtarësisë, jo drejtim i mbyllur dhe i kapur nga interesa personale. Zgjedhje të lira, të ndershme dhe transparente, pa imponime dhe pa lista të parapërgatitura. Rikthim i unitetit, meritokracisë dhe respektit për kontributin e

secilit. Kjo është thirrje për shpëtim politik të LDK-së”, ka thënë Veliu. Ai ka shtuar se heshtja dhe nënshtrimi përballë dështimit vetëm sa e thellojnë krizën dhe e largojnë partinë nga qytetarët. “Duke u angazhuar për proces transparent zgjedhor, nuk kërkoj privilegje, por shpreh gatishmërinë të kontribuoj me përvojën time politike në funksion të reformimit, unitetit dhe rikthimit të besimit të humbur. Partia nuk i përket një individi, apo një grupi të vogël. LDK-ja është e anëtarëve dhe votuesve të saj. Nëse nuk ndryshojmë tani, humbjet vetëm do të vazhdojnë”, ka thënë Veliu.



NDAHEN CERTIFIKATAT PËR 32 TRAJNERË TË ZBATIMIT TË ARSIMIT DUAL NË KOSOVË

**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 27 JANAR - Ministria në detyrë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, mori pjesë në punëtorinë “Përmbyllja dhe Certifikimi i Programit për Trajnerë të Trajnerëve dhe Mësimdhënës të Praktikës Profesionale mbi Zbatimin e Arsimit Dual në Kosovë”, e organizuar nga MASHTI në bashkëpunim me GIZ.

Në këtë aktivitet u certifikuan 32 trajnerë nga shkollat e arsimit profesional të cilët kanë përmbyllur me sukses fazën e fundit të trajnimit. Në fjalën e saj, ministria Nagavci vlerësoi angazhimin dhe kontributin e trajnerëve gjatë gjithë procesit, duke theksuar se certifikimi i tyre përbën një përgjegjësi të rëndësishme për bartjen e përvojave dhe praktikave të mira te mësimdhënësit e tjerë dhe për avancimin e zbatimit të Arsimit Dual në Kosovë. Ministria theksoi më tej se ndërlidhja e arsimit profesional me tregun e punës mbetet një nga prioritetet kryesore të MASHTI-t. Programi i Arsimit Dual zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, me mbi 800 biznese të përfshira në të gjithë Kosovën, duke u mundësuar nxënësve zhvillimin e aftësive profesionale në kushte reale të punës. Ky program realizohet me mbështetjen e GIZ-it dhe bazuar në praktikat e vendeve gjermanofolëse. MASHTI mbetet e përkushtuar që, në bashkëpunim me shkollat, komunat dhe partnerët, ta vazhdojë zgjerimin dhe forcimin e arsimit dual edhe me profile të tjera, në dobi të nxënësve, bizneseve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Spitalit “Isa Grezda” në Gjakovë i shtohen shtatë mjekë të rinj specialistë

GJAKOVË, 27 JANAR - Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë i janë bashkuar shtatë mjekë të rinj specialistë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zgjerimin dhe avancimin e shërbimeve mjekësore për pacientët. Me angazhimin e këtyre specialistëve, spitali “Isa Grezda” në Gjakovë do ta zgjerojë gamën e shërbimeve shëndetësore, duke rritur ndjeshëm cilësinë e kujdesit mjekësor dhe duke ofruar trajtim më të specializuar për pacientët. Drejtoria e Spitalit thekson se përforcimi i stafit me kuadro profesionale është pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe rritjen e standardeve të trajtimit. Mjekët e rinj specialistë janë:

Dr. Lorena Rruka - specialiste e dermatologjisë; Dr. Fahruk Iljazi - specialist i endokrinologjisë; Dr. Arton Hoti - specialist i pulmologjisë; Dr. Halit Delija - specialist i pulmologjisë; Dr. Durim Nuza - specialist i pulmologjisë; Dr. Lisa Qurdina - specialiste e oftalmologjisë; Dr. Fatbardh Kadrija - specialist i gastroenterologjisë.



Kurti takon ambasadorët Westerlund dhe Hargreaves, flasin për zgjedhjet e 28 dhjetorit

PRISHTINË, 27 JANAR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka zhvilluar një takim të përbashkët me ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund dhe ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Çështjet aktuale, përmbyllja e procesit zgjedhor të 28

dhjetorit dhe formimi i institucioneve në vijim, prioritetet e qeverisë së ardhshme dhe bashkëpunimi në fusha me interes të përbashkët, ishin ndër temat kryesore të këtij diskutimi të përbashkët. Në takim kryeministri theksoi përkushtimin ndaj sundimit të ligjit gjithandej Kosovës pa

diskriminim e privilegje për të gjithë qytetarët dhe komunitetet, rritjen e vazhdueshme ekonomike dhe përparimin shoqëror e avancimin demokratik si dhe angazhimin për paqe e siguri me rend publik dhe kufij të mbrojtur dhe integrimin në Bashkimin Evropian dhe NATO.



OSMANI PËR PROJEKTLIGJIN PËR LUGINËN E PRESHEVËS: DISKRIMINIMI SISTEMATIK NDAJ SHQIPTARËVE MË NUK ËSHTË I PADUKSHËM

PRISHTINË, 27 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se avancimi i Projektligjit për vlerësimin e diskriminimit në Luginë të Preshevës dërgon mesazhin se, sipas saj, “diskriminimi kundër komunitetit shqiptar në Serbi më nuk është i padukshëm apo tolerohet”. “Serbia vazhdimisht ka kryer shkelje autoritare të të drejtave të minoriteteve, përfshirë fushatën e pasivizimit të qëllimshëm për pastrim etnik përmes mjeteve administrative, shtypjes së gjuhës shqipe, mospërfshirjen në institucionet publike, diskriminimin në arsim, marginalizimin ekonomik dhe frikësimin nga autoritetet qendrore”, tha Osmani përmes një postimi në X. Anëtarët e Komitetit për Punë të Jashtme të Kongresit amerikan kanë votuar më 21 janar për të dërguar përpara këtë projektligj, që i kërkon sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, të përgatisë një raport gjithëpërfshirës për trajtimin e pakicave etnike në Serbi, veçmas të shqiptarëve që jetojnë në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, që njihen edhe si Luginë e Preshevës.

Osmani falënderoi anëtarin e Dhomës së Përfaqësuesve, Keith Self, që ka sponsorizuar projektligjin, kryetarin e Komitetit për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve, Brian Mast dhe anëtarët e tjerë të këtij trupi që votuan për “avancimin e projektligjit me mbështetje dypartiake”.



Pasi ta kalojë shqyrtimin e plotë, ky projektligj raportohet nga Komiteti për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve dhe do t'i dërgohet për votim gjithë Dhomës së Përfaqësuesve. Më pas ai duhet të miratohet edhe nga Senati dhe të nënshkruhet në ligj nga presidenti amerikan,

Donald Trump. Ky projektligj kërkon të vlerësohen çështje me rëndësi, përfshirë pasivizimin e adresave të shqiptarëve, kufizimet në përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet publike, diskriminimin në arsim, përfshirë mosnjohjen e diplomave të Kosovës dhe

mungesën e teksteve shkollore në gjuhën shqipe. Çështja e diplomave është rregulluar me disa marrëveshje të arritura në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel dhe me një marrëveshje mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në samitin në kuadër të Procesit të

Berlinit. Kosova i ka respektuar këto marrëveshje. Ndërkaq, sa i përket pasivizimit, shqiptarët në Luginë shpesh janë ankuar dhe kanë protestuar. Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve prej adresave ku kanë qenë të regjistruar. Ky hap rezultoi me humbjen e shtetësisë serbe, e rrjedhimisht të të gjitha të drejtave civile - përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për të pasur sigurim shëndetësor e pension dhe për t'u punësuar. Kjo çështje është përmendur edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në Serbi, për vitin 2023. Shqiptarët që jetojnë në jug të Serbisë ankohen edhe për mungesë të teksteve shkollore në gjuhën shqipe, gjë për të cilën Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete financiare. Kosova i ka ndihmuar ata edhe në sektorë të tjerë, sikurse bujqësia, por është ankuar se Serbia po i bllokoi pagesat. Avancimi i projektligjit është mirëpritur nga politikanë shqiptarë dhe nga Këshilli Kombëtar Shqiptar në Serbi. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022, në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë dhe janë pakica e katërt më e madhe në këtë shtet. Në raportet ndërkombëtare, Luginë e Preshevës konsiderohet tërësisht e izoluar dhe thuhet se merr vëmendje vetëm në kohë zgjedhjesh.

ZKA-ja auditon procesin e furnizimit me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla

PRISHTINË, 27 JANAR - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës “Furnizimi me barna nga Ministria e Shëndetësisë” për periudhën 2022-2024. Subjekt i këtij auditimi janë Ministria e Shëndetësisë, si dhe komuna e Lipjanit, Gjilanit, Rahovecit, Mitrovicës së Jugut si

dhe komuna e Ferizajt. Në fokus të auditimit do të jenë planifikimi, kontraktimi, shpërndarja dhe menaxhimi i barnave, me synim rritjen e efikasitetit në sektorin shëndetësor. Auditimi do të vlerësojë nëse Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në mënyrë ekonomike dhe efikase në procesin e furnizimit dhe shpërndarjes së

barnave për kujdesin shëndetësor parësor dhe për sëmundjet e rralla. Sipas raportimeve mediatike, ndonëse qeveria ka ndarë buxhet të konsiderueshëm për këto barna, në praktikë vazhdon të ketë mungesa. Aktualisht MSh-ja përmbush vetëm 35 - 40 % të nevojave reale për disa barna, duke detyruar komunat dhe qytetarët që t'i sigurojnë ato vetë.



VAZHDON BLOKADA E TRANSPORTUESVE RAJONALË NË KUFIJTË ME BE-në



PRISHTINË, 27 JANAR - Shoferët e kompanive transportuese nga Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina po e vazhdojnë edhe më 27 janar bllokadën e tyre nëpër pikat kufitare për trafikun e mallrave.

Pas bllokimit të daljeve një ditë më parë, tani transportuesit i kanë bllokuar edhe hyrjet nëpër pikat kufitare të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian.

Shoferët janë duke bllokuar terminalët për mallra për shkak të ashpërsimit të procedurave për të hyrë në Zonën Schengen. Ata thonë se procedurat tani janë më të komplikuar dhe mund t'ua shkurtojnë kohën e qëndrimit në vendet e Bashkimit Evropian. Ata po kërkojnë që qëndrimi i tyre në Bashkimin Evropian të rritet në katër muaj në krahasim me tre që është tani brenda gjashtë muajve.

Kompanitë transportuese kanë paralajmëruar që bllokadat do të zgjasin për shtatë ditë, përveç

Çfarë është sistemi EES?

I njohur si EES (Entry/Exit System), ky sistem u vendos në kufijtë e jashtëm të zonës Schengen dhe nisi të zbatohej gradualisht më 12 tetor 2025. Ai pritet të jetë plotësisht funksional deri më 10 prill 2026.

Rregulli i ashtuquajtur “90/180 ditë” parasheh që transportuesit nga vendet jashtë Schengenit mund të qëndrojnë në këtë zonë maksimumi 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh.

nëse gjendet një zgjidhje. Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Markus Lammert, ka thënë më 26 janar se institucionet evropiane po punojnë në gjetjen e mundësive që t'ua lejojnë punëtorëve të disa profesioneve, përfshirë shoferët e kamionëve, që të qëndrojnë në Zonën Schengen më gjatë sesa e përcaktojnë rregullat aktuale. “Ne jemi të vetëdijshëm se një numër i punëtorëve prej shteteve të treta, që nuk janë punëtorë ndërkufitarë, mund të kenë nevojë të qëndrojnë në Zonën Schengen për më shumë se 90

ditë brenda periudhës 180-ditore. Kjo përfshin profesionet me mobilitet të lartë, sikurse shoferët e kamionëve, por edhe atletët dhe artistët”, ka thënë Lammert. Sipas tij, Bashkimi Evropian është i vetëdijshëm për shqetësimet e shprehura nga operatorët e transportit në rajon dhe është duke vëzhguar nga afër situatën, si dhe është në kontakt me partnerët të Ballkanit Perëndimor.

Ndikimi i bllokadave në tregun e Kosovës

Si importuese e shumë mallrave

përmes Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, Kosova pritet të ndiejë pasojat e protestave në qarkullimin e mjeteve të transportit.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, njëherësh udhëheqës i Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor, thotë se Kosova nuk merr pjesë në protestë, pasi vendi nuk ka ende kompani logjistike që realizojnë transport të rregullt me vendet e BE-së. Por, paralajmëron se efektet e saj do të ndihen edhe në Kosovë. “Për shkak të bllokadës së kufijve, Kosova nuk do të mund as të eksportoje dhe as të importojë mallra”, thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë.

Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës për vitin e kaluar, vendi ka importuar produkte në vlerë prej mbi 7 miliardë eurosh në total, ose rreth 20 milionë euro në ditë - një sasi të madhe të tyre përmes Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Vlera e eksporteve, ndërkaq, ishte rreth 942 milionë euro

vitin e kaluar, apo rreth 2.6 milionë euro në ditë.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës u bëri thirrje institucioneve të vendit që të vihen në kontakt me BE-në për gjetjen e një zgjidhjeje.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi Qeverinë në detyrë të Kosovës për këtë çështje dhe është në pritje të përgjigjes.

Nënkryetari i Shoqatës së Transportuesve të Mallrave nga Kosova, Besnik Aliu, thotë për Radion Evropa e Lirë se transportuesit në Kosovë përballen me sfida të ngjashme me kolegët e tyre në rajon, për shkak të sistemit EES. Sipas tij, edhe pse në Kosovë janë të licencuar rreth 2 000 kamionë për transport mallrash, sektori mbetet i dobët në transportin ndërkombëtar, pasi shumica e importeve dhe eksporteve realizohen nga kompani të rajonit dhe BE-së. “Nuk është e lehtë të gesh shoferë për tregun e BE-së, sikurse gjenden për transportin brenda Kosovës apo në rajon”, thotë ai.

Arrestohen tre zyrtarë të komunës së Prishtinës për ryshfet dhe keqpërdorim të detyrës

Prishtinë, 27 janar - Tre zyrtarë të komunës së Prishtinës janë arrestuar gjatë një aksioni më 27 janar, nën dyshimet për veprat penale të “keqpërdorimit të detyrës zyrtare” dhe “marrjes së ryshfetit”.

Prokuroria Themelore në Prishtinë tha se aksioni u krye me masa të veçanta hetimore dhe një nga zyrtarët u zu në flagrancë duke marrë ryshfet. “Gjatë zbatimit të masave të veçanta hetimore janë shoqëruar tre persona, ndër të cilët zyrtari i komunës, A. G., është arrestuar në flagrancë për

veprën penale ‘marrje e ryshfetit’ sipas nenit 421 të Kodit Penal, me qëllim që të ndihmojë të dëmtuarin të realizojë një pagesë për punët të cilat i kishte kryer sipas kontratës me komunën”, u tha në njoftimin e Prokurorisë, institucion që inkurajoi qytetarët që të raportojnë për rastet e korrupsionit.

Ndërkaq, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, tha se komuna do të ofrojë bashkëpunim me organet përgjegjëse për këtë rast. “Në këtë frymë, kryeqyteti Prishtina mbetet i hapur për çdo proces verifikimi dhe



veprim procedural, në frymë bashkëpunimi dhe me respekt të plotë për organet e drejtësisë të Republikës së Kosovës”, shkroi Rama në “Facebook”.

Sipas ligjeve në fuqi, për marrje të ryshfetit, një zyrtar mund të dënohet me gjobë, por edhe me burgim deri në 15 vjet, varësisht nga vlera materiale që rezultojnë nga kjo veprë penale.

Ndërkaq, për keqpërdorim të detyrës zyrtare, po ashtu, parashihen dënime të ndryshme, që arrijnë deri në 10 vjet burgim, varësisht nga vlera e përftimit apo dëmit të shkaktuar nga kjo veprë penale.

NATO MUND TË MOS I MBIJETOJË EPOKËS SË TRUMPIT



Nga Ivan KRASTEV

Evropa ishte e zhytur në ankth pas Luftës së Parë Botërore. Për të forcuar mbrojtjen kundër Gjermanisë, francezet ndërtuan në vitet ‘30 Vijën Maginot, një sistem gjigant fortifikimesh, pengesash dhe instalimesh ushtarake përgjatë kufijve të Francës me Germaninë. Në vitin 1940, Gjermania e anashkaloi atë, duke pushtuar mospërmasë Belgjikës, Holandës dhe Luksemburgut në veri, dhe në fund e mundi Francën brenda gjashtë javësh.

Besimi pothuajse mistik i elites franceze në paprekshmërinë e Vijës Maginot ishte një nga arsytet e humbjes së çuditshme në vitin 1940, argumentonte historiani William L. Shirer në librin e tij të mirënjohur “Ngritja dhe rënia e Rajhut të Tretë”. “Francezët besuan fort te një vijë fortifikimi që, në fund, rezultoi me shumë një patericë psikologjike sesa një aset strategjik,” shkruante ai. Sot po bëhemi dëshmitarë të shpërbërjes së rendit evropian të

pas Luftës së Ftohtë dhe rrezikut real të një çarjeje në aleancën transatlantike, si pasojë e sulmeve të Presidentit Donald Trump ndaj Evropës dhe vendosmërisë së tij për të blerë ose aneksuar Groenlandën. Kjo gjendje na detyron të pyesim nëse historianët e së ardhmes do të argumentojnë se besimi evropian te Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) ishte Vija Maginot e mendësisë evropiane, një patericë psikologjike që krijoi një ndjesi të rreme sigurie dhe e pengoi Evropën të përgatitej për t’u përballur me sfidat e veta ekzistenciale.

Si e formësoi NATO-ja Evropën

A mos vallë ndjesia aktuale e brishtësisë së Evropës është mbi të gjitha një dështim i imagjinatës evropiane? Shumica e vendim-marrësve evropianë bien dakord në biseda private, se amerikanëve nuk mund t’u besohet më mbrojtja e aleatëve të tyre. Megjithatë, publikisht ata

këmbëngulin se NATO-ja mbetet jetike për mbrojtjen e Evropës. Publiku evropian është më pak diplomatik. Një studim i fundit i kryer nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë (ECFR) tregon se vetëm 16% e evropianëve shohin Shtetet e Bashkuara si aleat. Ndoshta edhe më domethënëse është se një e pesta e të anketuarve e përshkruajnë SHBA-në si kundërshtar ose rival.

Në periudhën pas Luftës së Ftohtë, NATO ishte “feja” e fundit e Evropës. Ajo ishte më shumë sesa një aleancë mbrojtëse; ishte Fryma e Shenjtë që sundonte botën në fundin e historisë. Evropianët ishin të magjepsur nga fuqia ushtarake amerikane dhe nuk shihnin arsye për të dyshuar në angazhimin e Uashingtonit për sigurinë e Kontinentit të Vjetër. Ekzistenca e NATO-s u mundësoi shumicës së evropianëve të fantazonin se një luftë e madhe në Evropë ishte e paimagjinueshme në shekullin XXI. Besnikëria evropiane ndaj NATO-s i pengoi ata të kuptonin

se, në mjedisin pas Luftës së Ftohtë, veçanërisht në Evropën Lindore, çmilitarizimi i Evropës, dhe jo ndërtimi i kapaciteteve të saj mbrojtëse, ishte shndërruar në detyrën qendrore të aleancës. Në kundërshtim me bindjen që ekziston, zgjerimi i NATO-s drejt Evropës Qendrore në vitin 1999 nuk erdhi si përgjigje ndaj ndonjë kërcënimi të përjetshëm rus, por nga frika e rikthimit të nacionalizmit dhe luftërave të frymëzuara prej tij. NATO u zgjerua drejt Evropës Lindore pas luftërave në ish-Jugosllavi dhe e shihte veten si një mburojë që mbronte Evropën nga demonët e së kaluarës së saj. “Paqja evropiane sot nuk është thjesht mungesë lufte, por marginalizimi i luftënxitjes nga jeta e shteteve, një ndryshim i thellë kulturor dhe institucional,” shkruante James J. Sheehan në historinë e tij të vitit 2008 për Evropën pas Luftës së Dytë Botërore, “Ku kanë shkuar të gjithë ushtarët?” Trajtimi i pakicave kombëtare, më shumë sesa kapacitetet mbrojtëse, u bë një nga arsytet kryesore për t’iu bashkuar

aleancës atlantike. Për dekada me radhë, forcat evropiane nuk u stërvitën për mbrojtje autonome, por për të luftuar së bashku me amerikanët dhe, pothuajse gjithmonë, nën komandën amerikane. Roli paradoksal i NATO-s si instrument çarmatimi, më shumë sesa ndërtimi i ushtrive të afta, gjen ilustrimin më të qartë në një dyshe të pazakontë: Suedia dhe Finlanda, të cilat për dekada i rezistuan anëtarësimit, iu bashkuan NATO-s vetëm pas pushtimit rus të Ukrainës dhe sot përfaqësojnë anëtarët më të gatshëm për luftë të aleancës. Rreth 15 vjet më parë, Robert Gates, Sekretar i Mbrojtjes në administratën e Barack Obamës, artikuloi padurimin amerikan ndaj vetëkënaqësisë evropiane për sigurinë ndërkombëtare dhe boshllëqeve në financimin e mbrojtjes brenda NATO-s. “Nëse prirjet aktuale të rënies së kapaciteteve mbrojtëse evropiane nuk ndalen dhe nuk përmbysen, udhëheqësit e ardhshëm politikë amerikanë, ata për të cilët Lufta e Ftohtë nuk ka qenë përvojë formuese, siç

ishte për mua, mund të mos e konsiderojnë më të vlefshëm kthimin e investimit amerikan në NATO, në raport me me koston,” paralajmëroi Gates.

Evropianët nuk ishin gati ta besonin.

Dhe më pas, në skenën politike u shfaq Donald Trumpi. Pasi pranoi nominimin republikan për president në korrik 2016, ai foli për kushtëzimin e mbrojtjes amerikane për aleatët e NATO-s që do gjendeshin të sulmuar, në varësi të kontributeve të tyre në aleancë. Pas zgjedhjes së tij, Trumpi kërcënoi privatisht tërheqjen nga aleanca gjatë një samiti në Bruksel. Evropa e lexoi këtë si retorikë boshe dhe priti që ai të largohej nga detyra. Në janar 2025, Trumpi u rikthye në Shtëpinë e Bardhë. Dhe për evropianët, tashmë ishte tepër vonë për të ndërtuar alternativa.

Trumpi dhe e ardhmja e NATO-s

Cila është e ardhmja e NATO-s në një botë trumpiane, ku Evropa ka humbur rolin e saj qendror për Shtetet e Bashkuara? Dhe çfarë mund të themi për llogaritjen e re, që deri tani është pëshpëritur, por që po besohet gjithnjë e më shumë, se të qenit aleat i Amerikës po bëhet më e rrezikshme, sesa të qenit armik i saj? Trumpi nuk ndryshoi thjesht pozicionin e Evropës në hartën amerikane të botës; ai solli një hartë të re me të cilën Uashingtoni e sheh botën. Ai nuk e konsideron sistemin e aleancave amerikane si një aset.

Ai e percepton atë si një barrë. Ndërsa disa e kanë zili Uashingtonin për rrjetin e tij të aleancave, Trumpi ka zili Kinën pikërisht sepse ajo nuk është e kufizuar prej aleatëve. Mospëlqimi i tij ndaj aleancave shpjegon, të paktën pjesërisht, faktin pse ai e sheh luftën në Ukrainë si të ngjashme me vitin 1914, kur vrasja e Dukës Franz Ferdinand në Sarajevë nga një nationalist serb, e shtyu Austro-Hungarinë t’i shpallte luftë Serbisë dhe të niste një zinxhir ngjarjesh, që solli shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Kur Trumpi vështroi krizën në Evropë, ai nuk duket se mendon për gabimin britanik, kur Londra besoi se kishte blerë paqen pas firmosjes së marrëveshjes me Adolf Hitlerin në Mynih, në vitin 1938. Trumpi e vlerëson rrezikun që SHBA të rrëshqasë pa e kuptuar drejt një lufte katastrofike dhe të panevojshme me Rusinë e Vladimir Putinit si shumë më të madh, krahasuar me rrezikun e qetësismit të një fuqie revizioniste që kërkon të rikthejë nën kontroll disa pjesë të Evropës. Për Trumpin, lufta e Rusisë në Ukrainë është Sarajevë, jo Mynih. Pyetja për të ardhmen e NATO-s duhet kuptuar si përgjigje ndaj dy çështjeve të ndara. Për administratën Trump, pyetja është se çfarë roli ka NATO-ja në një moment kur Amerika nuk e sheh më Bashkimin Evropian si një projekt amerikan, por megjithatë dëshiron ta mbajë Kontinentin e Vjetër brenda sferës së vet të influencës. Ky është një vizion ku SHBA kërkon të zëvendësojë Perëndimin e Luftës së Ftohtë, i përshkruar si “bota e lirë” dhe i përkufizuar

nga vlera liberale të përbashkëta, me një Perëndim kulturor, të rrënjosur te krishtërimi dhe raca e bardhë. Për evropianët, pesha e kësaj dileme është e ndryshme, por jo më pak urgjente. Ata e shohin NATO-n si thelbësore për t’i bërë ballë sulmit të Trumpit dhe për të ndërtuar kapacitetet e tyre mbrojtëse në një botë gjithnjë e më anarkike, ku garancitë amerikane të sigurisë nuk mund të merren më si të mirëqena. Trumpi mund të tundohet të besojë se, nëse NATO-ja nuk ekziston, nuk ka asnjë arsye pse presidenti rus Vladimir Putin të mos bëhet miku më i mirë i Uashingtonit. Ndërsa evropianët mund të tundohen të besojnë se rritja e buxheteve të mbrojtjes do të mjaftojë për të mbrojtur Evropën, në mungesë të Shteteve të Bashkuara.

Teatri i Perandorisë Amerikane


Operacioni i guximshëm special i SHBA-së në Venezuelë ishte një shfaqje e fuqisë perandorake. Ai shërbeu si një parathënie e asaj që mund ta quajmë imperializëm teatral, një fenomen në zhvillim, në të cilin fuqitë e mëdha demonstrojnë forcë për të sunduar, pa qeverisur realisht. Njëkohësisht, ai është edhe një sinjal se strategjia më e fundit e sigurisë kombëtare e Uashingtonit duhet marrë fjalë për fjalë. I kuptuar kështu, qëndrimi i administratës Trump bëhet i lexueshëm: Trumpi nuk synon të shkatërrojë NATO-n, por të përdorë ankthin evropian nga braktisja amerikane, si një mjet presioni për të riformatuar Evropën.

Me gjasë, evropianët do të jenë në gjendje të mbrojnë veten, por Evropa ka njëkohësisht një “problem kohe” dhe një “problem politik”. Ajo duhet të reduktojë varësinë nga teknologjitë dhe armët amerikane, ndërkohë që në të njëjtën kohë, duhet ta mbajë Trumpin të kënaqur dhe të ruajë iluzionin se mund të mbështetet ende te fuqia ushtarake amerikane. Për Trumpin, lufta e Rusisë në Ukrainë duket se përfaqëson një mundësi. Ashtu si një kompani private sigurie që shfrytëzon rritjen e rrezikut për të rritur çmimin e shërbimeve të veta, Uashingtoni shfrytëzon brishtësinë evropiane dhe përfiton nga përshkallëzimi i tensioneve mes Rusisë dhe aleatëve evropianë. Nga ana e tyre, rusët e shohin Evropën si armik dhe Trumpin si një aleat natyror. Lord Hastings Lionel Ismay, gjenerali dhe diplomati britanik që shërbeu si i pari Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, thoshte se qëllimi i aleancës ishte “t’i mbante amerikanët brenda, sovjetikët jashtë dhe gjermanët poshtë.” Strategjia aktuale e Rusisë mund të përshkruhet kështu: t’i mbajë amerikanët brenda, evropianët jashtë dhe ukrainasit poshtë. Evropianët duhet të përgatiten për kërcënimet e vazhdueshme të Trumpit për aneksimin e Groenlandës, një akt që do të shkelte integritetin territorial të një shteti anëtar të NATO-s. Ekziston një mundësi reale që një aneksim i tillë, Krimea e Trumpit, si të thuash, të ndodhë brenda këtij viti. Udhëheqësit evropianë kaluan një vit duke u përpjekur ta lajkatonin Trumpin dhe duke premtuar blerje armësh

amerikane, por ultimatumi i tij ndaj Evropës, që të heqë dorë nga Groenlanda ose të përballet me tarifa më të larta, po i shtyn ata me shpatulla pas murit. Duke e përshkruar sjelljen e Trumpit si shkelje të disa “vijave të kuqe”, kryeministri belg Bart De Wever vërejtë se Evropa duhet të bëjë një zgjedhje dhe se “të jesh një vasal i lumtur është një gjë, të jesh një skllav i mjerë është diçka tjetër.” Evropa do të detyrohet ta bëjë këtë zgjedhje. Evropa ende ka një nevojë të dëshpëruar për NATO-n. Dhe rëndësia e saj në botë do të varet nga gatishmëria për të jetuar në një botë pa aleancën atlantike. Çdo shpresë se evropianët do të mobilizohen përballë kërcënimeve të dyfishta nga Trumpi dhe Putini është frymëzuese, por jorealiste. Sipas një sondazhi të fundit të ECFR-së, 20% e atyre që e shohin Amerikën si kundërshtar janë njëkohësisht edhe më pak entuziastët për rritjen e buxheteve të mbrojtjes. Udhëheqësit evropianë duhet t’i bindin shoqëritë e tyre se e kuptojnë dallimin mes të lajmturit e rolit të budallait dhe të qenit vërtet budalla. Të jesh budalla do të thotë të besosh, pavarësisht provave që tregojnë të kundërtën, se Amerika do të qëndrojë krah Evropës në rast të një pushtimi rus, apo të besosh se, sapo Trumpi të largohet nga pushteti, SHBA-ja do ta rifitojë arsyen e humbur. Sfida kryesore strategjike e Evropës është të rikujtojë parullën: NATO-ja ka vdekur. Rroftë NATO-ja!

TIME – Bota.al





Xherdan Shaqiri bëhet me trajner të ri

BASEL, 27 JANAR - Stephan Lichtsteiner është trajneri i ri i Baselit duke firmosur kontratë deri në vitin 2029. Ish-lojtari i Lazios dhe Juventusit, i cili kishte punuar asistent në sektorin e të rinjve të klubit, është

larguar nga pozita e trajnerit te Wettswil-Bonstetten, skuadër që garon në divizionin e katërt. 42-vjeçari ka zëvendësuar Ludovic Magnin, i cili është shkarkuar, pasi skuadra ndodhej në vendin e katërt

në renditje: kuqebllutë janë 10 pikë larg Thunit, që kryeson kampionatin si skuadër e promovuar nga liga e dytë. Xherdan Shaqiri është duke luajtur sezonin e dytë me Baselin që prej rikthimit të tij. 34-vjeçari

vitin e kaluar ka arritur ta fitonte kampionatin duke dhënë kontribut të madh me 18 gola e 21 asistime. Edhe këtë sezon Shaqiri ka shifra të rëndësishme në Superligën e



Zvicrës, duke realizuar 9 gola dhe 10 asistime.

ADEMI DHE WESTERLUND DISKUTOJNË PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT KOSOVË - SUEDI NË SFERËN E FUTBOLLIT

PRISHTINË, 27 JANAR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka pritur në takim ambasadorin e Suedisë në vendin tonë, Jonas Westerlund. Ademi ka bërë me dije se me ambasadorin suedez ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Suedisë në sferën e futbollit. "Sot në selinë e FFK-së prita me kënaqësi ambasadorin e Suedisë në Kosovë, mikun e

futbollit kosovar, z. Jonas Westerlund. Gjatë takimit diskutuam për projektet e përbashkëta dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Suedisë në sferën e futbollit. Theks i veçantë iu kushtua projektit të Kampit në Leposaviq, i cili tashmë është shndërruar në një qendër të rëndësishme për zhvillimin e futbollit në vendin tonë", ka shkruar Ademi në "Facebook".



EDONA THAÇI, SHQIPTARJA E PARË KOMENTATORE NË WNBA

PRISHTINË, 27 JANAR - Edona Thaçi, ish-basketbolliste e përfaqësueses së Kosovës, sot analiste, komentatore dhe reportere sportive, është bërë pjesë e USA Network për mbulimin e WNBA, duke shënuar arritje të rëndësishme profesionale në karrierën e saj në Shtetet e Bashkuara të



Amerikës dhe duke u bërë shqiptarja e parë komentatore në ligën elitare të basketbollit për femra WNBA. Për Edonën kjo arritje është shumë më tepër sesa një sukses personal. Ajo e përjeton këtë moment si shpërblim i punës së palodhshme dhe të çdo sakrifice gjatë rrugëtimit

profesional që nuk ka qenë aspak i lehtë për të. Ajo shpreson që ky sukses të shërbejë si frymëzim për vajzat shqiptare që të besojnë në vetvete dhe të ëndërrojnë më shumë, veçanërisht për ato që luajnë basketboll apo synojnë një karrierë në gazetarinë sportive. Mesazhi i

saj për brezat e rinj është të ëndërrojnë dhe mos të dorëzohen kurrë. "Të ëndërrojnë gjëra të mëdha, të jenë të durueshëm, të besojnë në vetvete dhe të mos dorëzohen kurrë, pavarësisht pengesave", ka thënë Edona për Federatën e Basketbollit të Kosovës.

LLAPI ZYRTARIZON TRANSFERIMIN E HARIS IBRISAAGICIT



PODUJEVË, 27 JANAR - KF Llapi ka zyrtarizuar një tjetër përforcim në repartin defensiv, duke arritur marrëveshje me qendërmbrojtësin 20-vjeçar nga Bosnjë-Hercegovina, Haris Ibrisaagic. Mbrojtësi i ri ka nënshkruar kontratë me klubin llapjan me kohëzgjatje prej 3 vjet e gjysmë, duke u bërë pjesë e projektit afatgjatë

të KF Llapit, që synon ndërtimin e një skuadre konkurruese me lojtarë të rinj dhe perspektivë. Ibrisaagic vjen si produkt i akademisë të njohura boshnjake, Zheljezničar Sarajevo dhe FK Sarajevo, dy klube me traditë në zhvillimin e talenteve. Gjatë karrierës së tij ai ka qenë pjesë edhe e FC Cosmoc dhe FC

Bishkek City, nga ku edhe realizohet transferimi drejt skuadrës së Superligës së Kosovës. Qendërmbrojtësi tashmë i është bashkuar ekipit në fazën përgatitore që po zhvillohet në Turqi dhe prej disa ditësh po stërvitet rregullisht me pjesën tjetër të skuadrës.

Ronaldo në vitin 2021 kishte parashikuar se Carricku mund të bëhet trajner i shkëlqyer

MANCHESTER, 27 JANAR - Është rikthyer në vëmendje një deklaratë e Cristiano Ronaldos, e thënë për Michael Carrick me të cilin ai ka pasur fatin ta ndaj fushën me fanellën e

Manchester Unitedit. Ai në vitin 2021 kishte theksuar se Carrick ka predispozitat për t'u bërë trajner i shkëlqyer në të ardhmen. "Michael Carrick ishte një lojtar i shkëlqyer dhe ai mund të

bëhet edhe një trajner i shkëlqyer. Asgjë nuk është e pamundur për këtë djalë. Personalisht, jam krenar që kam luajtur me të në krah, si dhe me të si trajner në stolin tonë", kishte thënë

Ronaldo. Marrë parasysh startin e shkëlqyeshëm të rikthimit të Carrick te Manchester Unitedit, këto fjalë të Ronaldos po dalin të jenë të sakta.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “HIGHERPlan” SH.P.K. pronar Vjollca Zymberi Devaja me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812354091 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “HIGHERPlan” D.O.O. Vjollca Zymberi Devaja Gnjilane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812354091 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “HIGHERPlan” L.L.C. with owner Vjollca Zymberi Devaja with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812354091 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “P&S TOPALAJ” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812172162 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “P&S TOPALAJ” D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812172162 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “P&S TOPALAJ” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812172162 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nezaj Trading Group” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812230233 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nezaj Trading Group” D.O.O. Djakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812230233 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nezaj Trading Group” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812230233 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

“Palma” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810679417, Gjilan me pronar Ekrem Shahini bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 1759953.92 Euro në 4000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zahrije Makshana shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Vëllezërit Frashëri” Drenovc Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Rexhep Rexhepishpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Zenel Sadiku” Babaj Bokes Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Beqir Deva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Automekanik në Gjakovë.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “ Ymer Prizreni” Prizren.
- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.

“FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

